



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 353/02-5041 dt. 29.01 2024



Bazuar në nenin 11,12, dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, dhe nenit 26 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronë së Paluajtshme të Komunës. Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.01.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës SHFMU "Rasim Kiqina" në Shtrubullovë

I.

MIRATOHET propozimi për caktimin e lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës SHFMU "Rasim Kiqina" në Shtrubullovë, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit – MASHTI në fshatin Shtrubullovë.

II.

Lokacioni ku do të ndërtohet objekti i paralelës së shkollës SHFMU 'Rasim Kiqina' në Shtrubullovë ka këto karakteristika:

Është pronë e Komunës së Drenasit, dhe është në zonën kadastrale në Shtrubullovë, në pjesën e ngastrës kad.202-0, me $S = 42964 \text{ m}^2$, e cila sipas PZHK-së dhe Hartës Zonale është e planifikuar si tokë ndërtimore, sipërfaqja e nevojshme për realizimin e këtij projekti është 18500 m^2 .

II.

Qëllimi për caktimin e këtij lokacioni ka të bëjë me realizimin e Projektit për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës SHFMU 'Rasim Kiqina' në Shtrubullovë, ku parcela P-70315077-00202-0, dhe sipas PZHK-së dhe Hartës Zonale janë planifikuar për ndërtim.

III.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodozike, kadastrale dhe pronësore, që nevojiten për regjistrimin në RDPP.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Drenasit.

V.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: Skica, Kopja e planit dhe Çertifikata e njësisë kadastrale.

VI.


Me këtë Vendim do të njoftohen organët kompetente të Komunës së Drenasit.

VII.

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

A r s y e t i m

Sipas kërkesës së MASHTI-së e cila edhe është donator i këtij projekti, punimet për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës SHFMU'Rasim Kiqina' në Shtrubullovë, andaj për tu kryer punët sipas standardeve të kërkuara është e domosdoshme të miratohet ky vendim dhe të caktohet lokacioni i shënuar më lartë, për arsye të realizimit të projektit për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës 'Rasim Kqina'.

Pra projekti për ndërtimin objektit të paralelës së shkollës SHFMU'Rasim Kiqina' në Shtrubullovë, do të financohet nga MASHTI, vlenë të ceket se në parcelen 202-0 është lokacion i planifikuar për ndërtim dhe gjindet në lokacion të përshtatshëm për të gjithë komunitetin e zonës, prandaj edhe është zgjedhur ky lokacion për ndërtimin e paralelës së shkollës'Rasim Kiqina' në Shtrubullovë.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka caktuar ekipin profesional i cili ka përcaktuar dhe ka bërë matjet gjeodezike të lokacionit për ndërtimin e objektit të paralelës së shkollës SHFMU'Rasim Kiqina' në Shtrubullovë, sipas kërkesës së DA-së ka përgaditur dokumentet e nevojshme gjeodezike.

Pjesë përbërse e këtijë propozim-vendimi janë edhe Çertifikata mbi të drejtat e pronës, kopja e planit dhe skica e propozuar e lokacionit.